



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 16.05.2025

Numër Protokolli: 3293/2025

A.nr.465/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.465/2025, të datës 13.03.2025, të parashtruar nga ankuesja F.K., kundër organit të punësimit/Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 16.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.465/2025, e datës 13.03.2025, e parashtruar nga ankuesja F.K.

II. Ndryshohet Vendimi me numër protokolli 01/157, i datës 05.02.2025, i Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ashtu që **shfuqizohet** pika II e dispozitivit, ndërsa **mbetet në fuqi** pjesa tjetër e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, F.K. (*tutje referuar vetëm ankuesja*), më datë 13.03.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1661/2024, të regjistruar nën shenjën A.nr.465/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 01/157, të datës 05.02.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: SKGJK*), ndërsa ky i fundit me datë 28.04.2025 ka dorëzuar përgjigjen në ankesë, se bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 2789/2025 të datës 28.04.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesja edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshme referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 1661/2025 të datës 13.03.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshill; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë; Listat e pagave të ankueses; Flete kthesën; Akt emërimit me Nr.03/1321 të datës 01.07.2024; Përshkrimin e detyrave të punës.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e pa bazuar, **sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se ankuesja fillimisht sipas Akt emërimit me numër Reference 03/112-322 të datës 28.12.2012, ka qenë e punësuar në pozitën “Referente”, në Gjykatën Themelore në Gjilan, në kuadër të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa sipas Akt emërimit me numër protokolli 03/952 të datës 30.06.2023, e njëjta është e punësuar në pozitën e punës “Mbikëqyrëses së Sektorit për Pranim, Dorëzim dhe Menaxhim të Lëndëve”, Klasa J15, koeficienti i pagës 5.85.

Tutje, sipas shkresave të lëndës Kolegji i Këshillit, ka gjetur se Këshilli Gjyqësor i Kosovës, më datë 06.06.2024 ka miratuar Rregulloren Nr.02/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësor, dhe si rezultat i kësaj organi përkatës i punësimit më datë 01.07.2024, i ka lëshuar ankueses Akt emërimit me numër protokolli 03/1321, për pozitën e njëjtë atë “Mbikëqyrëses së Sektorit për Pranim, Dorëzim dhe Menaxhim të Lëndëve”, Klasa J14, koeficienti i pagës 7.50.

Si rrjedhojë, ankuesja përmes shkresës me numër protokolli 03/450 të datës 11.10.2024, i është drejtuar Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me kërkesë për kompensim të retroaktiv të diferencës së pagës nga Klasa J15 koeficienti i pagës 5.85 në Klasën J14 me koeficientin e pagës 7.50, dhe atë për periudhën kohore që nga data 30.06.2023, si datë e akt emërimit në këtë pozitë deri në muajin qershor 2024, ndërsa Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës përmes Vendimit me numër protokolli 03/3587 të datës 31.10.2024, ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar ankueses kërkesën e datës 11.10.2024.

Ankuesja kundër Vendimit me numër protokolli 03/3587 të datës 31.10.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më datë 21.11.2024 kishte parashtruar ankesë në Këshill, mbi pretendimet ankimore se vendimi i kontestuar me ankesë është nxjerrë mbi vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, për çka kërkon aprovimin e ankesës dhe njohjen e të drejtës së kompensimit retroaktiv të diferencës së pagës nga data 30.06.2023 deri në muajin qershor 2024 (12 muaj), rrjedhimisht obligimin ndaj organit përkatës i punësimit për kompensimin e mjeteve financiare.

Këshilli, përmes Vendimit A.nr.1759/2024 të datës 30.12.2024, kishte aprovuar si të bazuar ankesën e ankueses, ashtu që për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale kishte shfuqizuar Vendimin numër protokolli 03/3587 të datës 31.10.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe çështjen e kishte kthyer rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë.

Ndërsa, Drejtori i Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më datë 05.02.2025, ka nxjerrë Vendimin me numër protokolli 157, përmes të cilit ka refuzuar kërkesën e ankueses me numër protokolli 03/450 të datës 11.10.2024, ndërsa sipas II të dispozitivit ka lënë në fuqi Vendimin numër protokolli 03/3587 të datës 31.10.2024, të shfuqizuar sipas Vendimit A.nr.1759/2024, të datës 30.12.2024, të Këshillit.

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Vendimi me numër protokolli 157, i datës 05.02.2025, është nxjerrë përmes vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, për çka kërkon aprovimin e ankesës dhe njohjen e të drejtës së kompensimit retroaktiv të diferencës së pagës nga data 30.06.2023 deri në muajin qershor 2024 (12 muaj), rrjedhimisht obligimin ndaj organit përkatës i punësimit për kompensimin e mjeteve financiare.

Kolegji i Këshillit, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses, analizoi dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenit 2, në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: 1. *Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit,.....* 2. *Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj* 3. *Për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, **Sistemin e Drejtësisë**, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, ky ligj zbatohet për aq sa nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë., dhe nenin 14, paragrafi 3, të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. *Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik.**

Andaj, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil në Sistemin e Drejtësisë përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcën Nr.2 të këtij ligji, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të punës për nëpunësit civil me status të veçantë, të përcaktuar sipas nenit 6 paragrafit 4 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, konkretisht me nenin 38 paragrafin 7, ku përcaktohet se: 7. *Procedurat sipas paragrafit 6. të këtij neni, për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese rregullohen me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të këtyre institucioneve.* kështu që, bazuar në këto dispozita ligjore rrjedhë së të punësuarit në administratë të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor kanë statusin e nëpunësit civilë më status të veçantë dhe së mbi këtë bazë ligjore Këshilli Gjyqësor me akt të veçantë ligjor ka rregulluar procedurën e klasifikimit të vendeve të punës të nëpunësve civilë në këtë institucion, gjegjësisht me Rregulloren Nr.02/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësorë të Kosovës, e miratuar më datë 06.06.2024.

Rrjedhimisht, duke qenë se Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, lidhur me zbatimin e shtojcës Nr.2, të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ka nxjerrë Vendimin me numër protokolli 01/57 të datës 23.01.2023, për Klasifikimin e Vendeve të Punës për të Punësuarit në Gjyqësor, i zbatueshëm që nga hyrja në fuqi e këtij ligji, dhe pozita e ankueses *Mbikëqyrëse e Sektorit për Pranim, Dorëzim dhe Menaxhim të Lëndëve*, është klasifikuar në grupin e pozitave profesionale Grupi J, Klasa J15, koeficienti 5.85, ndërsa ndryshimi i koeficientit të saj dhe lëshimi i Akt emërimit me numër protokolli 03/1321 të datës 01.07.2024, është si rezultat i miratimit të Rregullores Nr.02/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësorë të Kosovës, ku sipas Nenit 19 përcaktohet përshkrimi i përgjithshëm i punës, klasat dhe emërtesat për kategorinë Drejtues i Ulët, dhe sipas paragrafit 6 nën paragrafi 6.1 pozita e ankueses, hynë në Grupin J, Klasa J14, Koeficienti 7.5, sipas shtojcës Nr.2 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa sipas nenit 32 është përcaktuar, që Sekretariati jo më vonë se tre (3) muaj, nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje t’ju ofrojë zyrtarëve aktual nënshkrimin e akt emërimeve dhe/apo kontratave të reja, dhe si për rrjedhojë, Kolegji i Këshillit, konstaton se pretendimet ankimore të ankueses janë të pa bazuara, ngase e njëjta për periudhën të cilën kërkon kompensim retroaktiv të diferencës së të ardhurave personale, apo përkatësisht për nga data 30.06.2023 e deri në Qershor të vitit 2024, sipas listës së pagave rezultoi se ka realizuar koeficient të pagës sikurse është përcaktuar me vendimin e sapo theksuar dhe Akt emërim të cilin e njëjta e ka nënshkruar pa vërejtje, gjegjësisht në vlerën e koeficientit 5.85 ndërsa pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, sipas listës së pagave rrjedhë se ankuesja nga muaji Korrik 2024, ka realizuar koeficient të pagës në vlerën 7.5, kurse nga muaji Janar 2025, e njëjta realizoi koeficient të pagës 8, rrjedhimisht ankueses nuk i është cënuar asnjë e drejtë nga marrëdhënia e saj e punës apo thënë më konkretisht nga e drejta e realizimit të pagës bazë.

Theksuar si më sipër, Kolegji i Këshillit, konstaton se pretendimi ankimor i ankueses është i pa bazuar ngase ndryshimi i koeficientit të saj të pagës, siç u theksua edhe më sipër është si rezultat i miratimit të Rregullores Nr.02/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësorë të Kosovës, e cila nuk ka fuqi prapavepruese duke shtuar faktin e pa kontestueshëm se ankuesja ka realizuar të hyra financiare, përkitazi me vlerën e koeficientit të përcaktuar në aktet e themelimit të marrëdhënies së punës, ndërsa nga analizimi i aktit kontestues Kolegji i Këshillit, konstaton se Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokolli 157, përmes të cilit ka refuzuar kërkesën e ankueses me numër protokolli 03/450 të datës 11.10.2024, është akt i cili ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe juridike, lidhur me pretendimet ankimore të ankueses, ngase i njëjti në rastin konkret ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të cilat rregullojnë dhe përcaktojnë pagën bazë për nëpunësit civil të Administratës së Sistemit Gjyqësor, konkretisht sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe Rregullores Nr.02/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësorë të Kosovës.

Mirëpo, nga akti kontestues rezultoi se Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, përkatësisht sipas II të dispozitivit, ka lënë në fuqi Vendimin numër protokolli 03/3587 të datës 31.10.2024, duke vepruar në kundërshtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore, gjegjësisht ka vepruar në kundërshtim me nenin 21 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: *“Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës”*, vendim i cili paraprakisht ishte shfuqizuar përmes Vendimit A.nr.1759/2024, të datës 30.12.2024, të Këshillit, ndërsa kujtojmë faktin se sipas nenit

22 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: “Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit të përcaktuar me dispozitat e ligjit për konfliktin administrativ. 2. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit”, nga rrjedh se Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, nuk ka autoritet apo autorizim të rrikthejë në fuqi një akt administrativ i cili është shfuqizuar nga organi epror përmes vendimit që në procedurë administrative është vendim i formës së prerë, sikurse janë vendimet e Këshillit, madje në rastin konkret Vendimi i A.nr.1759/2024, i datës 30.12.2024 ishte bërë i ekzekutueshëm.

Prandaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenit 132 paragrafi 2 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS **Lënda me numër A.nr.465/2025**

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses F.K.;
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.